

# **AKTI I THEMELIMIT**

TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“ OnTaxiElek ” SH.P.K**

## **EMERTIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 1**

Prej shtetases shqiptare :

- **Znj. Julita Shabani**, shtetas shqiptare, e bija e Vasil e lindur në Kuçovë më 10/09/1983, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartes se identitetit me nr. personal I35910058N, banuese në Adresën, Lagja “Pavarësia” , Rr” Fejzo Gjomema”, Vlorë.

është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “ **OnTaxiElek** ” sh.p.k.

## **Selia e Shoqërisë**

### **Neni 2**

Selia e shoqërisë “ **OnTaxiElek** ” sh.p.k do të jetë Vlorë, Autoveturë elektrike Volkswagen, ngjyrë e bardhë, targa AB890NT.

Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **Objektivi i Veprimtarisë**

### **Neni 3**

*Objekti i veprimtarisë* së shoqërisë do të jetë si vijon : Shërbim TAXI.

## **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

### **Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar nga momenti i nënshkrimit të këtij statuti.

## **Kapitali I Shoqërisë**

### **Neni 5**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është përcaktuar në masën 100.000,00 Lekë (njqind mijë) dhe është tërësisht kapital financiar i depozituar prej ortakëve themelues.

Kapitali është i ndarë në *1 kuote* me vlerë 100.000 (njqind mijë) Lekë .

Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortakja themeluese **Julita Shabani** : Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 100.000,00 Lekë (njqind mijë) që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve është në para

### **Drejtimi i Shoqërisë Neni 6**

Administratore e shoqërisë do të jetë **znj. Julita Shabani**.

Shoqëria “ **OnTaxiElek** ” sh.p.k do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do të ushrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe me normat e aktit themelues dhe të statutit bashkëngjitur.

Ky akt themelimi nënshkruhet prej ortakëve themelues në datë **31/05/2024**

### **Neni 7**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të saj në përputhje me pjesëmarjen e tyre .

### **Neni 8**


Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

### **Neni 9**

Akti i themelimit u përpilua në 3 kopje , për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “ OnTaxiElek” sh.p.k

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

## **ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ OnTaxiElek”**



**Data** : 31/05/2024

**Vendi** : VLORE